

LIGJ
Nr. 44/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja me vendin pritës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Ballkanit Perëndimor, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.7.2018

Shpallur me dekretin nr. 10847, datë 26.7.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

MARRËVESHJE
ME VENDIN PRITËS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
FONDIT TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Republika e Shqipërisë, në vijim e referuar si “Vendi Pritës” dhe Fondi i Ballkanit Perëndimor, në vijim i referuar si “Fondi”, të dyja së bashku të referuara si “Palët”,

duke in referuar “Marrëveshjes për themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor”, të nënshkruar në Pragë, më 13 nëntor 2015;

duke vërejtur se Marrëveshja parashikon krijimin e Selisë së Fondit të Ballkanit Perëndimor në Tiranë, Republika e Shqipërisë;

duke dëshiruar rregullimin e privilegjeve dhe imuniteteve të nevojshme për funksionimin dhe përmbushjen e suksesshme të misionit të Fondit,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Palë Kontraktuese” nënkupton një Palë Kontraktuese të Marrëveshjes për Themelimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor”;

b) “Fond” nënkupton Fondin e Ballkanit Perëndimor;

c) “Sekretariat” nënkupton Sekretariatit të Fondit;

d) “Drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrrejtor ekzekutiv” nënkupton një person të emëruar si drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrrejtor ekzekutiv të Fondit;

e) “Personel ndërkombëtar” nënkupton një anëtar të personelit të Sekretariatit, me kusht që të mos jenë shtetas të vendit pritës dhe as shtetas i huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës;

f) “Personel i rekrutuar në vend” nënkupton një anëtar të personelit të Sekretariatit, i cili është shtetas i vendit pritës ose shtetas i huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës;

g) “Anëtar i familjes” nënkupton një bashkëshort, fëmijë të pamartuar deri në moshën 18 vjeç dhe midis 18 dhe 23 vjeç, me kusht që ata të ndjekin studimet e plotë akademike në vendin pritës, persona me aftësi të kufizuara nën kujdesin e anëtarit të stafit ndërkombëtar, me kusht që të jetojnë në vendin pritës në të njëjtën shtëpi me drejtorin ekzekutiv, zëvendës drejtorin ekzekutiv, përfaqësuesin dhe një anëtar të personelit ndërkombëtar dhe se ata nuk janë shtetas të vendit pritës ose shtetas të huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës;

h) “Ekspert i kontraktuar” nënkupton një person që kryen një mision të përkohshëm për Fondin, i kontraktuar nga ky i fundit;

i) “Përfaqësues” nënkupton një zyrtar të caktuar apo të dërguar nga një prej Palëve Kontraktuese pranë Fondit;

j) “Ambiente të Fondit” nënkupton objektet, duke përfshirë tokën ndihmëse të tyre, të zëna nga Fondi dhe të përdorura vetëm për qëllimet e Fondit.

Neni 2

Selia e Fondit

Selia e Fondit ndodhet në Tiranë, kryeqyteti i Republikës së Shqipërisë. Vendi pritës do t'i sigurojë Fondit, pa pagesë, objektet e nevojshme dhe hapësirat e duhura, si dhe pajisje, orendi për përmbushjen efektive të funksioneve të saj për pesë vitet e para pas themelimit të Fondit.

Neni 3

Personaliteti juridik

Fondi, i themeluar si një organizatë ndër-kombëtare, gëzon personalitet të plotë juridik sipas ligjit shqiptar dhe ka aftësi juridike për të përmbushur funksionet e veta për të lidhur kontrata, për të blerë dhe për të shitur prona të luajtshme dhe të paluajtshme, si edhe për të vendosur dhe për të ndjekur procedurat ligjore.

Neni 4

Logoja dhe përcaktimet

1. Fondi mund të shpalosë flamurin, logon dhe simbolet e tjera në mjediset e tij dhe në mjetet motorike të Fondit.

2. Mjetet motorike të Fondit kanë të drejtën e regjistrimit diplomatik dhe statusin përkatës sipas legjislacionit të vendit pritës.

Neni 5

Imunitetet dhe privilegjet

1. Fondi do të gëzojë imunitete dhe privilegje të garantuara për të gjitha misionet diplomatike të akredituara në vendin pritës.

2. Ambientet e Fondit janë të pacenueshme.

3. Shteti pritës do të garantojë që selia e Fondit të jetë e pacenueshme. Autoritetet kompetente të vendit pritës kanë të drejtë të hyjnë në ambientet e Fondit për të kryer detyrat e tyre vetëm me pëlqimin e drejtorit ekzekutiv të Sekretariatit ose një zyrtari të autorizuar të Sekretariatit. Megjithatë, në rast zjarri ose emergjence të ngjashme, një pëlqim i tillë konsiderohet se është dhënë nëse nevojiten masa mbrojtëse të menjëhershme.

4. Dokumentet dhe materialet arkivore të Fondit, duke përfshirë të gjitha aplikacionet kompjuterike dhe dosjet digjitale që i përkasin atij ose në zotërim të tij, janë të paprekshme.

5. Importi dhe eksporti i botimeve, si dhe i materialeve informative për përdorim nga Fondi, përjashtohen nga të gjitha tatimet dhe taksat.

6. Fondi, asetet, të ardhurat dhe pasuri të tjera të tij përjashtohen nga taksat e drejtpërdrejta kombëtare dhe vendore. Ky përjashtim nuk zbatohet për tatimet dhe fondet e caktuara për një qëllim që konsiderohen si tarifa për shërbimet komunale të ofruara sipas normave të përcaktuara, sipas sasisë së shërbimeve të ofruara, të cilat mund të identifikohen, përshkruhen dhe ndahen.

7. Fondi ka të drejtë të importojë sasi të arsyeshme mallrash pa detyrim tatimor dhe doganor për përdorim zyrtar të tij, duke përfshirë edhe automjetet zyrtare.

8. Për sa i përket tatimit mbi vlerën e shtuar të përfshirë në çmime ose të faturuara veçmas, përjashtimi do të zbatohet vetëm për sasi të arsyeshme të artikujve të blerë dhe shërbimeve të bëra për përdorim zyrtar nga Sekretariati, rast në të cilin mallrat e blera për përdorim prej tij, në lidhje me të cilat zbatohen përjashtimet në përputhje me këtë dispozitë, nuk mund të shiten, jepen ose asgjësohen në ndonjë mënyrë tjetër, përveç në kushtet e rëna dakord me qeverinë e vendit pritës.

9. Qeveria e vendit pritës ndërmerr të gjitha masat për të mbrojtur ambientet e Fondit nga çdo ndërhyrje ose dëmtim, cenim ose shkelje e dinjitetit të Fondit.

Neni 6

Disponimi i fondeve

Për qëllime të ushtrimit të funksioneve të tij, Fondi ka të drejtë të marrë, mbajë, shkëmbejë, transferojë të gjitha fondet, monedhat, paratë e gatshme dhe t'i shpërndajë lirisht ato, në përputhje me rregullat e vendit pritës nën të njëjtat kushte si për misionet diplomatike.

Neni 7

Kontributet individuale për Fondin

Kontributet e bëra nga individët dhe subjektet private për Fondin nuk janë subjekt i imuniteteve dhe privilegjeve diplomatike.

Neni 8

Sigurimet shoqërore

1. Drejtori ekzekutiv, zëvendës drejtori ekzekutiv, përfaqësuesit dhe personeli ndërkombëtar përjashtohen nga pagesa e kontributeve të detyrueshme në lidhje me çdo lloj sigurimi shoqëror në vendin pritës.

2. Personeli i rekrutuar në nivel vendor u nënshtrohet të gjitha kontributeve të detyrueshme, në përputhje me legjislacionin e vendit pritës.

Neni 9

Drejtori ekzekutiv dhe zëvendës drejtori ekzekutiv i Fondit

1. Gjatë mandatit të detyrës së tij në vendin pritës, drejtori ekzekutiv dhe zëvendës drejtori ekzekutiv i Fondit gëzojnë imunitete dhe privilegje të dhëna për drejtuesit e zyrave të ngjashme të organizatave ndërkombëtare në vendin pritës, të parashikuara në nenin 10 më poshtë.

Neni 10

Imunitetet dhe privilegjet e personelit ndërkombëtar

Gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre zyrtare në territorin e vendit pritës, personeli ndërkombëtar dhe familjarët e tyre mbajtes të pasaportave zyrtare, përveç nëse janë shtetas të vendit pritës ose shtetas të huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës, gëzojnë imunitetet dhe

privilegjet e mëposhtme në vendin pritës:

- a) Imunitet nga juridiksioni penal i vendit pritës në lidhje me të gjitha veprimet e kryera nga ai/ajo në funksionin zyrtar të tij/saj, duke përfshirë fjalët e folura ose të shkruara;
- b) Imunitet nga juridiksioni civil dhe administrativ, përveç kur bëhet fjalë:
 - 1. Për një veprim real lidhur me një ndërtesë private që ndodhet në territorin e vendit pritës, përveç kur ai e posedon atë për llogari të Fondit dhe për qëllimet e misionit;
 - 2. Për një veprim lidhur me një trashëgimi, në të cilën personeli ndërkombëtar figuron si zbatues i testamentit, administrator, trashëgimtar, si privat dhe jo në emër të Fondit;
 - 3. Për një veprim lidhur me një profesion të lirë ose me një aktivitet tregtar çfarëdoqoftë, të ushtruar nga personeli ndërkombëtar në vendin pritës jashtë funksioneve të tij zyrtare;
- c) Paprekshmërinë e të gjitha dokumenteve zyrtare;
- d) Paprekshmërinë e bagazhit të tij/saj zyrtar;
- e) Paprekshmërinë e bagazhit të tij/saj personal;
- f) Përjashtimin në lidhje me të gjitha taksat e drejtpërdrejta dhe të njëjtat privilegje në lidhje me lehtësirat e shkëmbimit që i akordohen personelit diplomatik.

Neni 11

Privilegjet e përfaqësuesve

Gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre përfaqësuesit e caktuar apo të dërguar nga një prej Palëve Kontraktuese pranë Fondit, të cilët nuk janë mbajtës të pasaportave zyrtare gzojnë privilegjet e mëposhtme:

- a) Përjashtimin në lidhje me të dhe anëtarët e familjes së tij/saj që përbëjnë pjesë të familjes së tij/saj nga kufizimet e emigracionit dhe regjistrimi i të huajve;
- b) Të drejtën për të importuar pa doganë orenditë dhe sendet personale të tij/saj në kohën e fillimit të funksionit të tij/saj dhe rieksporimit të tyre pa doganë;
- c) Të drejtën për të importuar automjetin e vet privat për përdorimin personal të tij/saj dhe më pas për rieksporimin e këtij automjeti pa doganë.

Neni 12

Personeli i rekrutuar në nivel vendor

- 1. Personeli i rekrutuar në nivel vendor punësohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit pritës.
- 2. Personeli i rekrutuar në nivel vendor, në bazë të kësaj Marrëveshjeje, gëzon vetëm imunitetin nga juridiksioni për veprimet e kryera prej tyre gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre, duke përfshirë fjalët e folura ose të shkruara, në detyrën e tyre zyrtare.

Neni 13

Eksperti i kontraktuar

Gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre zyrtare në territorin e vendit pritës, ekspertët, përveç nëse janë shtetas të vendit pritës ose shtetas të huaj me vendbanim të përhershëm në vendin pritës, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

- a) Imunitetin nga juridiksioni për veprimet e kryera prej tyre gjatë përmbushjes së funksioneve të tyre, duke përfshirë fjalët e folura ose të shkruara, në detyrën e tyre zyrtare;
- b) Paprekshmërinë e të gjitha letrave zyrtare, të dhënave të mediave dhe dokumenteve, në përputhje me procedurat standarde;
- c) Përjashtimin nga kufizimet e emigracionit në përputhje me rregullat e vendit pritës.

Neni 14

Përfashtimi nga imuniteti

Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, është detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë marrëveshje, të respektojnë ligjet dhe rregulloret e vendit pritës.

Neni 15

Heqja dorë nga imuniteti

1. Privilegjet dhe imunitetet e parashikuara në këtë Marrëveshje nuk jepen për përfitime personale të zyrtarëve të Fondit që i gëzojnë ato, por për të garantuar ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre.

2. Në bazë të kërkesës me shkrim të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të vendit pritës për Sekretariatit të Fondit, Këshilli i Zyrtarëve të Lartë do të heqë imunitetin e çdo zyrtari të Sekretariatit, në çdo rast kur sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesin e Fondit. Heqja e imunitetit nga juridiksioni duhet të shprehet gjithmonë me shkrim.

3. Heqja e imunitetit nga juridiksioni në lidhje me procedurat administrative nuk do të konsiderohet për të nënkuptuar heqjen e imunitetit në lidhje me ekzekutimin e vendimit, për të cilin është e nevojshme një heqje dorë e veçantë.

Neni 16

Njoftimet

Sekretariati i Fondit i siguron Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme të vendit pritës:

a) Listën e përfaqësuesve, personelit ndërkombëtar dhe anëtarëve të familjeve të tyre që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, menjëherë ose maksimumi brenda tri ditëve nga data e mbërritjes së tyre;

b) Gjithashtu, Sekretariati i Fondit do të japë njoftim për skadimin e mandatit të çdo përfaqësuesi dhe personelit ndërkombëtar të njoftuar në përputhje me paragrafin “a” dhe, siç mund të jetë e nevojshme, që një person pushon të qeni anëtar familjeje i familjeve të tyre përkatëse.

c) Përfaqësuesit dhe personeli ndërkombëtar të njoftuar në përputhje me paragrafin e mësipërm dhe anëtarët e familjeve të tyre që janë pjesë e familjeve të tyre përkatëse, mbajtës të pasaportave zyrtare, pajisen me dokumentet e identifikimit të lëshuara nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme të vendit pritës, në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 17

Përgjegjësia e vendit pritës

Vendi pritës nuk konsiderohet përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e kryera nga Sekretariati dhe personeli i tij brenda territorit të tij.

Neni 18

Çështje të sigurisë

1. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk përjashton të drejtën e qeverisë së vendit pritës për të marrë të gjitha masat përkatëse të mbrojtjes në interes të sigurisë publike ose për të penguar zbatimin e ligjeve të vendit pritës, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e shëndetit dhe rendit publik.

2. Nëse qeveria e vendit pritës merr në konsideratë, se zbatimi i dispozitave të përmendura në paragrafin 1 më sipër është i nevojshëm, sapo ta lejojnë rrethanat, ajo kontakton Sekretariatit në mënyrë që të marrë një vendim të përbashkët për masat që mund të jenë të nevojshme për mbrojtjen e interesave të Fondit.

3. Sekretariati është i detyruar të bashkëpunojë me autoritetet e vendit pritës, në mënyrë që të shmangë

çdo dëm të sigurisë publike që rezulton nga ndonjë veprimtari e Fondit.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Të gjitha mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhen nëpërmjet bisedimeve ndërmjet Palëve.

2. Autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të natyrës private ndërmjet Fondit dhe entiteteve private dhe individëve do të jetë gjykata ku Fondi ka selinë e tij.

Neni 20

Ndryshimet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi në përputhje me nenin 21 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 21

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të Sekretariatit nga Republika e Shqipërisë se janë plotësuar të gjitha kërkesat e nevojshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Një kopje e këtij njoftimi u dërgohet të gjitha Palëve Kontraktuese të Ballkanit Perëndimor.

Neni 22

Përfundimi

Kjo marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.

Secila palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë, duke njoftuar me shkrim palën tjetër nëpërmjet kanaleve diplomatike. Ky përfundim do të hyjë në fuqi 6 (gjashtë) muaj pas datës së marrjes së këtij njoftimi nga Pala tjetër.

Neni 23

Depozitari

Qeveria e Republikës së Shqipërisë vepron si depozitar i kësaj Marrëveshjeje.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje depozitohet pranë depozitarit, i cili i dërgon një kopje të vërtetuar fondit dhe të gjitha Palëve Kontraktuese të Ballkanit Perëndimor.

Nënshkruar në, më, në dy origjinale në gjuhën angleze.

Për

Republikën e Shqipërisë

Për

Fondin e Ballkanit Perëndimor